



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/901

Datë: 26/9/2014

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur më 26.9.2014, mori vendim që të shpall

KONKURS PLOTËSUES

për pranimin e studentëve në afatin e dytë për studimet themelore- bachelor në vitin akademik 2014/2015

Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve, në afatin e dytë të konkursit për vitin akademik **2014-2015**, do të regjistrojë **3192** studentë, prej të cilëve **1854** studentë të rregullt dhe **1338** studentë me korrespondencë.

Si shtesë e numrit si më sipër, Universiteti do të regjistrojë edhe **196** studentë të rregullt nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, **32** studentë të rregullt nga diaspora, **14** studentë të rregullt shtetas të huaj, si dhe **408** studentë nga komunitetet jo-shumicë: boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe të tjerë. Në programet ku nuk janë paraparë kuota të veçanta për kandidatë nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, kandidatët kanë të drejtë konkurrimi në kushte të njëjta me kandidatët nga Kosova.

Kandidatët të cilët i takojnë familjes së ngushtë e dëshmorit (fëmijë ose bashkëshort/e), do të kenë një bonus prej 5 pikësh në pikët e përgjithshme me rastin e aplikimit. Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë dëshmi që i takojnë kësaj kategorie (vërtetim të shoqatës nga qendra në Prishtinë).

Kandidatët që i takojnë kategorisë së familjes së dëshmorit dhe që nuk arrijnë të kalojnë pragun minimal prej 30% të provimit pranues dhe ata të cilët edhe përkundër bonusit prej 5 pikësh nuk arrijnë të kualifikohen në listën e kandidatëve të pranuar do të konsiderohen të refuzuar.

Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti i Prishtinës rezervon të drejtën e pranimi të kandidatëve me nevoja të veçanta.

Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i.

Kandidatë jokosovarë konsiderohen ata që e kanë mbaruar shkollimin e mesëm jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet e shkollimit (Vendimi për njohje/nostrifikim të diplomave lëshohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë).

Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në të gjitha nivelet e studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës dhe që kanë statusin e studentit të rregullt nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi me status të studentit të rregullt.

Secili kandidat mund të konkurrojë vetëm në një fakultet, departament apo drejtim

E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës gjatë muajit tetor.

MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

I. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet e poshtëshënuara:

Fakulteti Filozofik; Fakulteti i Filologjisë; Fakulteti Juridik; Fakultetit Ekonomik; Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës; Fakulteti i Mjekësisë; Fakulteti i Arteve; Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit; Fakulteti i Edukimit, do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:

a. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë; dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 80 pikë.

b. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 50 pikë; dhe
- Suksesi në provimin pranues deri në 30 pikë.

II. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet e poshtëshënuar:

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore; Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike; Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, do të bëhet sipas kriterëve në vijim:

a. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë;
2. Suksesi në provimin pranues deri në 80 pikë.

b. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë;
2. Suksesi në maturë deri në 50 pikë;
3. Suksesi në provimin e maturës nga lëndët me përparësi për regjistrim në Fakultet deri në 30 pikë.

Lëndët me përparësi për regjistrim në Fakultet janë të shënuara në pjesën e konkursit ku bëhet fjalë për secilin prej këtyre fakulteteve.

Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit më së shumti me pesë pikë.

Për kandidatët nga pika **I.a**, në provim pranues, prej 80 pikëve, 40 pikë mund të arrihen nga pjesa teorike dhe 40 pikë nga pjesa praktike.

Për kandidatët nga pika **I.b**, në provim pranues, prej 30 pikë, 15 pikë mund të arrihen nga pjesa teorike dhe 15 pikë nga pjesa praktike.

Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, sipas pikave **a** dhe **b** kanë vetëm kandidatët që arrijnë **30%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në më së shumti tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.

Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtën dukuri, merret suksesi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse dukuria e numrit të barabartë të pikëve përsëritet, zgjedhjen e kandidatëve (deri te numri i paraparë për regjistrim), do ta bëjë Komisioni përkatës i Fakultetit.

Fakultetet janë të obliguara që tërë listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.

Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës apo drejtimit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.

Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 29. 9. 2014 deri më 07. 10. 2014 në ora 16.00. (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave, me datën 6.10.2014 nuk do të punohet për shkak të Festës së Bajramit).

2. Ditën e parë të konkursit, me datë 29.9.2014, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 10.00, ndërsa pranimi i dokumentacionit në njësitë akademike do të fillojë nga ora 13.00.

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- *Certifikatën e lindjes (origjinal),*
- *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal),*
- *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal),*
- *Kopjen e letërnjoftimit,*
- *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>***

- *Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Prishtinës, ndërsa pagesa bëhet në bankë,*

- *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostrifikimi),*

- *Për kandidatët që konkurrojnë për t'u regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, e që kanë mbaruar maturën, paraqesin edhe Vërtetimin mbi pikët e arritura nga lëndët në provimin e maturës.*

Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e këtyre fakulteteve. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

2. Provimi pranues do të mbahet më 09. 10. 2014, në orën 9:00, përveç në disa fakultete, ku orari i mbajtjes së provimit pranues është si vijon:

- **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në orën 11:00;**
- **Në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Fakultetin Ekonomik, provimi pranues do të mbahet më 10. 10. 2014, në orën 9:00.**

- Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

- **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

3. Shpallja e rezultateve të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më 13.10.2014 në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e fakultetit përkatës.

Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

Në departamentet, degët dhe drejtimet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, nuk do të shpallet konkursi tjetër plotësues.

Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-pr.edu

4. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet sipas fakulteteve prej 14. 10. 2014 deri më 18. 10. 2014, sipas këtij orari:

- Fakulteti Filozofik më 14. 10. 2014 prej orës 9:00 - 15:00 në Fakultetin Filozofik,

- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë 14. 10. 2014 prej orës 9:00 - 15:00 në Fakultetin Filozofik

- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore më 14. 10. 2014 prej orës 9:00 - 15:00, në Amfiteatrin e Fizikës së FSHMN-së;

- Fakulteti i Filologjisë më **14. 10. 2014** prej orës **9:00 - 15:00**, në Amfiteatrin e Fizikës së FSHMN-së;
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Mjekësisë më **15. 10. 2014**, prej orës **9:00 -15:00** në Fakultetet teknike;
- Fakulteti Juridik më **16. 10. 2014** prej orës **9:00 - 15:00**, në Amfiteatrin e Fakultetit Juridik;
- Fakulteti Ekonomik më **17. 10. 2014**, prej orës **9:00 -15:00** në Amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik;
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj më **18. 10. 2014**, prej orës **10:00 -14:00** në FSHA në Ferizaj
- Fakulteti i Edukimit , Fakulteti i Arteve dhe Fakulteti i Shkencave Sportive më **18.10. 2014** prej orës **9:00 - 15:00**, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë;

Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së largu deri më 30.10.2014. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
2. Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
3. Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës, vitin e parë të studimeve e kanë falas.
4. Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej **25 €** për studime të rregullta, respektivisht **125 €** për studime me korrespondencë.

Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja Universitetit të Prishtinës.

I. FAKULTETI FILOZOFIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **326** studentë, prej të cilëve **105** të rregullt dhe **221** me korrespondencë në departamentet si në vijim:

Departamenti	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Departamenti Filozofi	45	17
Programi Filozofi	45	17
Departamenti Punë Sociale	0	0
Programi Punë Sociale	0	0
Departamenti Histori	0	90
Programi Histori	0	90
Departamenti Shkenca Politike	0	43
Programi Shkenca Politike	0	43
Departamenti Sociologji	0	71
Programi Sociologji	0	71
Departamenti Psikologji	0	0
Programi Psikologji	0	0
Departamenti Etnologji dhe Antropologji Kulture	60	0
Programi Etnologji dhe Antropologji Kulture	22	0
Programi Arkeologji	38	0

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës sociale nga Edukata qytetare, Psikologji dhe Sociologjia .
- Në Departamentin e Historisë nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukatë qytetare
- Në Departamentin e Shkencave Politike nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare.
- Në Departamentin e Sociologjisë nga Sociologjia dhe Filozofia.
- Në Departamentin e Etnologjisë me Antropologji Kulture nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.

- Në Departamentin e Psikologjisë nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime.

III. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE – PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **120** studentë të rregullt, dhe atë në departamentet / programet si në vijim:

Departamenti i Matematikës	0
Programi Shkencat Kompjuterike	0
Programi Matematikë financiare në banka dhe sigurime	0
Programi Matematikë	0
Departamenti i Fizikës	30
Programi Fizikë	30
Departamenti i Kimisë	84
Programi Kimi	65
Programi Kimi Inxhinierike	19
Departamenti i Biologjisë	6
Programi Biologji	0
Programi Ekologji-Mbrojtje e mjedisit	6
Departamenti i Gjeografisë	0
Programi Gjeografi	0

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranimit janë:

- Për Departamentin e Matematikës: Matematikë, Fizikë dhe Informatikë;
- Për Departamentin e Fizikës: Fizikë, Matematikë, Informatikë;
- Për Departamentin e Kimisë: Kimi, Matematikë, Fizikë;
- Për Departamentin e Biologjisë: Biologji, Kimi, Fizikë;
- Për Departamentin e Gjeografisë: Gjeografi, Matematikë, Informatikë.

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës nga Fizika;
- Në Departamentin e Kimisë nga Kimia dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë nga Gjeografia.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **274** studentë, prej të cilëve **164** të rregullt dhe **110** me korrespondencë dhe atë në departamentet /programet si në vijim:

Departamenti, Programi	Studime të rregullta	Studime me korrespondencë
Departamenti i Gjuhës Shqipe	55	37
Programi Gjuhë Shqipe	55	55
Departamenti i Letërsisë Shqipe	31	38
Programi Letërsi Shqipe	31	38
Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	0	0
Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze	0	0
Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane	0	20
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	0	20
Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Frënge	31	5
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	31	5
Departamenti i Orientalistikës	22	0
Programi Orientalistikë	22	0

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke	25	10
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	25	10
Gjithsej	164	110

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të departamentit përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe nga Gjuha shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Letërsisë Shqipe nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge nga Gjuha frënge (me gojë);
- Në Programin e Orientalistikës nga Gjuha arabe (me gojë);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nga Gjuha turke (me gojë);
- Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga lëmit: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror dhe Ese.

IV. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **432** studentë me korrespondencë .

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Filllet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe.

V. FAKULTETI EKONOMIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **559** studentë me korrespondencë dhe atë si në vijim sipas departamenteve:

Departamenti	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet	0	199
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë	0	172
Departamenti Marketing	0	74
Departamenti Ekonomiks	0	72
Departamenti i Kontabilitetit	0	42

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë.

VI. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **24** studentë të rregullt dhe atë në departamentet / programet si në vijim :

Departamenti i Ndërtimtarisë	24
Programi Konstruktiv	0
Programi Hidroteknik	24
Programi Gjeodezi	0
Departamenti i Arkitekturës	0

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga Matematika, ndërsa në Departamentin e Arkitekturës edhe nga Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë (sllajdi).

Për tu ranguar kandidati duhet të arrijë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **78** studentë të rregullt dhe atë sipas departamenteve si në vijim:

Departamenti Inxhinierisë Kompjuterike	0
Departamenti Telekomunikacion	0
Departamenti Elektronikë	0

Departamenti Automatikë e Kompjuterizuar dhe Robotikë	35
Departamenti Elektroenergjetika	43

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës ,suksesi i së cilave do të merret parasysh për pranim, janë:

- Matematikë
- Fizikë
- Gjuhë shqipe

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **495** studentë të rregullt dhe atë sipas programeve si në vijim :

Programi Prodhimtari dhe Automatizim	81
Programi Termoenergjetikë dhe Termoteknologji	54
Programi Konstruksion dhe Mekanizëm	80
Programi Komunikacion dhe transport	64
Programi Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti	69
Programi Sistemet e Energjisë së Ripërtitshme	88
Programi Mekatronikë	59

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës ,suksesi i së cilave do të merret parasysh për pranim, janë:

- Matematikë
- Fizikë
- Informatikë

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **91** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Programi Mjekësi e Përgjithshme	0
Programi Stomatologji	0
Programi Farmaci	0
Programi Fizioterapi	32
Programi Infermieri	18
Programi Mami	41

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha degët e Fakultetit të Mjekësisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji. Për Degët Fizioterapi, Infermieri dhe Mami kandidati duhet të ketë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë

X. FAKULTETI I ARTEVE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **65** studentë të rregullt dhe atë në degët / programet si në vijim:

<i>Dega e Artit Figurativ</i>	17
Programi Pikturë	0
Programi Skulpturë	7
Programi Grafikë	4
Programi Dizajn Grafik	0
Programi Arti konceptual dhe mediet e reja	6
<i>Dega e Artit Muzikor</i>	34

Moduli Artistik-interpretim, kompozim, dirigjim	21
Programi Kompozim	1
Programi Dirigjim	2
Programi Solokëndim	0
Programi Piano	0
<i>Programet e Instrumenteve Harkore</i>	<i>12</i>
Violinë	1
Violë	3
Violonçeli	1
Kontrabas	6
Kitarë	1
<i>Programet e Instrumenteve me të Fryer</i>	<i>6</i>
Flaut	0
Klarinetë	0
Saksafon	0
Trompetë	0
Trombon	2
Tuba	2
Fagot	0
Obo	0
Korna	2
Programi Pedagogji e Përgjithshme Muzikore	13
<i>Dega e Artit Dramatik</i>	<i>14</i>
Programi Aktrim	3
Programi Dramaturgj	4
Programi Regji filmi dhe televizioni	0
Programi Regji teatri	4
Programi Dizajn skene	3

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t' i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEGËN E ARTIT FIGURATIV

Për përcaktimin e talentit për krijimtari artistike, kushtet e veçanta për studim në Degën e Artit Figurativ janë:

Programi i Pikturës

- Portfolio me 5 punime të punuara sipas modelit (studimi i kokës dhe figura në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj).

Programi i Skulpturës

- Portfolio me 5 punime nga skulptura sipas modelit, prej të cilave një duhet të jetë studimi i kokës në përpjesëtime natyrore dhe së paku 5 vizatime sipas modelit.

Programi i Grafikës

- Portfolio me punime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj.).

Programi i Dizajnit Grafik

- Portfolio me 5 vizatime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore), si dhe 5 punime nga dizajni grafik (ilustrime, kopertina të librit, ambalazhë etj.).

Programi Arti Konceptual dhe Mediet e Reja

Faza e parë

-portofolion me 10 punime nga mediumet e reja.

-kandidatët i shtrohen testit të përbërë prej 10 pyetjeve nga mediumet e reja në artet bashkëkohore.

Faza e dytë

-kandidatët që kalojnë fazën e parë i nënshtrohen pjesës së dytë, në të cilën fazë punohet një ese prej së paku 400 fjalë me temë të caktuar.

Faza e tretë

-puna praktike në mediumin që e zgjedh vetë kandidat:

1. Video,
2. Video instalacion,
3. Pikturë konceptuale,
4. Skulpturë konceptuale – instalacion etj.

Në të gjitha drejtimet e Degës së Artit Figurativ, do të organizohet interviste gojore apo me shkrim lidhur me njohuritë mbi profesionin që do të studiojnë.

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Programin e Pikturës: portet sipas modelit (1 ditë), vizatim i aktit (1 ditë) dhe pikturim sipas detyrës së dhënë (1 ditë).

- Në Programin e Grafikës: portet sipas modelit (1 ditë), vizatim i aktit (1 ditë) dhe pikturim sipas detyrës së dhënë (1 ditë).

- Në Programin e Skulpturës: portret sipas modelit (1 ditë), vizatim i aktit (1 ditë) dhe modelim sipas modelit (1 ditë).

- Në Programin e Dizajnit Grafik: portret sipas modelit (1 ditë), vizatimi i aktit (1 ditë) dhe detyra nga dizajni grafik (1 ditë). Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohja e përdorimit të kompjuterit.

Kandidatët punojnë me material të tyre.

NË DEGËN E ARTIT MUZIKOR

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

Në Programin e Kompozimit:

- Vlerësimi i 3 kompozimeve të dorëzuara, dhe provim nga lëndët solfezh, harmoni, polifoni e piano.

Në Programin e Dirigjimit

-Drejtimi i tri veprave korale si dhe provim nga lënda solfezh, harmoni dhe piano.

Në Programet Instrumentale

- provimi nga lëndët solfezh dhe teoria e harmonisë si dhe në instrument – lëndë kryesore (një koncert, një sonatë dhe një pjesë e lirë për drejtimet e harkorëve dhe frymorëve)

Në Programin e Pianos

- provim nga lëndët solfezh dhe teoria e harmonisë si dhe në piano – lëndë kryesore (një etidë, pjesa nga Baroku, sonatë dhe pjesë e lirë).

Në Programin Pedagogji e Përgjithshme Muzikore

-Provim nga lëndët solfezh dhe harmoni si dhe piano obligat.

Në Programin e Solo Këndimit

-provim nga lëndët solfezh dhe piano si dhe solo këndim (një ushtrim teknik, një kompozim nga shekulli XVII dhe XVIII, një arie nga veprat e oratoriumeve, një këngë solo nga autorët e shekullit XIX, një këngë solo të autorëve shqiptar, një arie operistike).

NË DEGËN E ARTIT DRAMATIK

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Programi Aktrim:

Pjesa e parë e programi eliminues:

- Recitim (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Monolog (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim;
- Një poezi.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- puna me mësimdhënës të caktuar,
- hartimi i detyrës me shkrim dhe
- verifikimi përfundimtar i aftësive.

Programi Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Programi i Regji Filmi

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t'i shtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë (film tre minutash).

Programi Dramaturgj:

Hartim me shkrim në temën e lirë,

Dialogu me shkrim në temën e tragjedisë,

Dialogu me shkrim në temën e komedisë,

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga sfera e kulturës së përgjithshme,

Testim me gojë nga fusha e dramaturgjisë.

Programi Dizajn skene

- Portfolio me 10 projekte ideore (skenografi): skica të skenografisë për dramë të caktuar, një skenografi të inskenuar në hapësirë të caktuar.

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Programin Dizajn skene: portret sipas modelit (1 ditë), vizatim i aktit (1 ditë) dhe detyrë nga piktura në skenografi (1 ditë).

- kandidatët i shtrohen testit nga regjia e filmit, TV dhe teatrit.

Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi dhe Dramaturgj

1. Georg Sodull - "Historia e filmit"
2. Abaz Hoxha - "Historia e filmit shqiptar"
3. Luis Herman - Skenari i filmit dhe i televizionit
4. Jezhi Plazhevski - Gjuha e filmit
5. Fadil Hysaj: "Teatrollogji, dramaturgj, regji dhe aktrim"
6. Aristoteli: "Poetika"
7. Vlladan Shvacov: "Bazat e dramaturgjisë"
8. Dr. Nebi Islami: "Historia e dramës kombëtare 1886-1996"
9. Dr. Josif Papagjoni: "Komedi që vjen nga skena"
10. Eskili: "Orestia"
11. Sofokli: Një tragjedi
12. Aristofani: Një komedi
13. Shekspiri: Një tragjedi
14. Moliere: Një komedi
15. Dramaturgj nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
16. Dramaturgj bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **292** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Programi Prodhimtaria bimore	136
Programi Menaxhimi i biznesit në zootekni	92
Programi Agroekonomi	0
Programi Teknologji ushqimore me bioteknologji	0
Programi Veterinari	64

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, sukcesi i të cilave do të merret parasysh për pranim, janë:

-Biologji

-Kimi

-Ndërmarrësi (ekonomi).

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues për Programet e Bujqësisë do të mbahet nga lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë, kurse për Programin e Veterinarisë do të mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **20** studentë të rregullt femra

PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

1. Gjendja Psiko-Somatike (verifikimi shëndetësor, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor).
2. Not
3. Aftësitë lëvizore (motorike):
 - Kërcimi nga vendi në gjatësi,
 - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt),
 - Përkulje mbi krah (femrat),
 - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit- meshkujt dhe femrat),
 - Qëndrueshmëria në 1000 m(meshkujt) dhe 800 m (femrat) - matet koha e vrapimit,
 - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor),
 - Ndjeshmëria ritmike.
4. Njohuritë lëvizore(motorike) sportive:
 - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë
 - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë
 - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh.
 - Volejbol: pasimi i topit në çifte me gishta dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
5. Gjymnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikajla mbi duar, kapërcimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).
Paralele: mbështetje mbi krah, me lëkundje ngritje-para, dalje me trup të shtrirë prapa.
Kandidatët janë të obliguar që në provim të kenë pajisjet sportive.

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT- PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **51** studentë prej të cilëve **35** studentë të rregullt dhe **16** studentë me korrespondencë dhe atë në programet si në vijim:

Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Programi Fillor	0	0
Programi Parashkollor	0	0
Programi Edukimi dhe Zhvillimi në fëmijërinë e hershme 0-3	35	0
Programi Pedagogji e përgjithshme	0	16

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për Programin Edukimi në fëmijërinë e hershme, Programin Fillor dhe Programin Parashkollor do të mbahet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe dhe Matematikë.

-Në Programin e Pedagogjisë nga Psikologjia Filozofia dhe Edukata qytetare, provimi është me shkrim.

XIV. FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **364** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Menaxhment Industrial	106
Inxhinieri Industriale me Informatikë	81
Arkitekturë e Interierit dhe dizajni i mobileve	71
Menaxhment i Turizmit dhe Hotelerisë	106

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës, sukcesi i së cilave do të merret parasysh për pranim, janë:

-Matematikë

	Programi Hidroteknik				1				1
	Programi Gjeodezi		2						2
	Departamenti i Arkitekturës	2	2	1	1	1			7
7	i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	3	5			2	0	0	10
Departamenti	i Kompjuterikes								0
	i Telekomunikacioni					1			1
	i Elektronikës		2			1			3
	i Automatikës	3	3						6
8	i Inxhinierisë Mekanike		2						2
Departamenti	i Prodhimtarisë dhe Automatizimit		2						2
	9	i Mjekësisë	10	8	5	5	6	8	3
Programi	Mjekësi e Përgjithshme				1	1			2
	Stomatologji	2	2	1		1			6
	Farmacii	2	2	1	1	1			7
	Fizioterapi			1	1	1			3
	Infermieri	3	2	1	1	1			8
	Mami	3	2	1	1	1			8
10	i Arteve	4	4	1	1	1	2		13
	Dega e Artit Figurativ	4	4	0	0	0			8
	Programi Pikturë	1	1						2
	Programi Skulpturë	1	1						2
	Programi Grafikë	1	1						2
	Programi Dizajn Grafik	1	1						2
	Dega e Artit Muzikor					1			1
	Dega e Artit Dramatik			1	1				2
11	i Bujqësisë dhe Veterinarisë		2	2	2	2			8
	Programet e Bujqësisë			1	1	1			3
	Programi Ekonomi e Bujqësisë								0
	Programi i Veterinarisë			1	1	1			3
13	i Edukimi Fizik dhe Sportit				2	2			4
	Meshkuj				1	1			2
	Femra				1	1			2
14	i Edukimit		1		1		2		4
	Programi fillor		1						1
21	i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj		0	3	3	3			9
Departamenti	Menaxhment Industrial			2	1	2			5
	Dizajni në Interior dhe Arkitektura e Mobileve			1	2	1			4
	Gjithsej	58	65	21	227	25	32	14	242

Universiteti i Prishtinës, për mësim në gjuhën shqipe, do të pranojë edhe **408** studentë nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë: boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe të tjerë.

Aplikimi i kandidatëve që i takojnë kësaj kategori do të merret parasysh vetëm nëse me rastin e aplikimit dorëzohet dëshmia-vërtetimi i lëshuar nga zyra e komuniteteve nga komuna përkatëse.

	Fakulteti	Boshnjak	Turq	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Të Tjerë	GJITHSEJ
01	Filozofik	12	9	5	5	4	10	45

Departamenti	Shkenca politike	8	4	2	2	1	4	21
	Sociologji	2	1	1	1	1	2	8
	Psikologji	1	2	1	1	1	2	8
	Arkeologji	1	2	1	1	1	2	8
02	i Shkencave Matematiko-Natyrore	9	6	3	3	3	6	30
Departamenti-Programi	Fizikë	3	2	1	1	1	2	10
	Kimi	3	2	1	1	1	2	10
	Biologji	3	2	1	1	1	2	10
03	i Filologjisë	11	9	6	6	6	6	44
Programi	Gjuhë Shqipe, Letërsi Shqipe	5	3	2	2	2	2	16
	Gj.dhe Letërsi Angleze	4	3	2	2	2	2	15
	Gj. dhe Letërsi Gjermane	2	3	2	2	2	2	13
04	Juridik	11	7	5	4	5	2	34
05	Ekonomik	9	9	5	5	3	4	35
Departamenti	Financa, banka dhe kontabilitet	5	4	3	3	3	2	20
	Menaxhment dhe informatikë	4	5	2	2		2	15
06	i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	9	9	5	5	5	4	37
Departamenti	Ndërtimtari	3	5	3	3	3	2	19
	Arkitekturë	6	4	2	2	2	2	18
07	i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	7	6	4	4	4	4	29
Departamenti	Kompjuterikë	2	3	2	2	2	2	13
	Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë e kompjuterizuar dhe Robotikë, Elektroenergjetika	5	3	2	2	2	2	16
08	i Inxhinierisë Mekanike	4	3	2	2	2	2	15
09	i Mjekësisë	13	2	4	5	4	8	36
Programi	Mjekësia e Përgjithshme	4		1	2	1	2	10
	Stomatologjia	3		1	1	1	2	8
	Farmacitë	4	2	1	1	1	2	11
	Fizioterapia	2		1	1	1	2	7
10	i Arteve	3	2	2	2	2	2	13
11	i Bujqësisë dhe Veterinarisë	8	4	2	2	2	4	22
Programi	i Bujqësisë	4	2	1	1	1	2	11

	i Veterinarisë	4	2	1	1	1	2	11
12	i Edukimit Fizik dhe Sportit	8	3	2	2	2	2	19
13	i Edukimit	5	2	8	8	8	4	35
	Programi i arsimit fillor	5	2	4	4	4	2	21
	Programi parashkollor			4	4	4	2	14
14	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara-Ferizaj	4	0	4	4	0	2	14
	Gjithsej	113	71	57	57	5	60	408

Vërejtje:

Në tabelën e paraqitur me kuotat për nxënësit të cilët e kanë përfunduar mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake duhet të merret parasysh gjuha e shkruar në dokumentacionin pedagogjik, dëftesat dhe diploma.

Përjashtim nga vërejtja e sipërhënuar bëhet për kandidatët nga komunat ku nuk organizohet mësimi në këto dy gjuhë dhe këta kandidatë duhet të paraqesin edhe një vërtetim për përkatësinë etnike të tyre.